

703
05.02.2016

KONTRATË KONCESIONI/PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT

E FORMËS ROT (REHABILITIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) PËR
REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E INFRASTRUKTURËS
HEKURRUDHORE FIER-BALLSH, FIER – VLORË

Ndërmjet

Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

dhe

Shoqërisë Koncesionare Albrail sh.p.k

04 Shkurt 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	6
1.1	Përkufizime.....	6
1.2	Interpretimi	11
1.3	Objekti Koncesionit.....	12
2.	DHËNIA, PERIUDHA DHE AUTORIZIMET E KONCESIONIT	12
2.1	Dhënia e Koncesionit	12
2.2	Periudha e Koncesionit.....	13
2.3	Autorizimet.....	14
3.	DATA E HYRJES NË FUQI TË KONTRATËS	14
4.	TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË KONCESIONARE	15
4.1	Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare.....	15
4.2	Detyrimet e Përgjithshme të Shoqërisë Koncesionare.....	15
5.	TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES	16
5.1	E Drejta e Autoritetit Kontraktues	16
5.2	Detyrimet e Përgjithshme të Autoritetit Kontraktues.....	17
6.	PUNIMET E REHABILITIMIT	19
6.1	Studimi i Fizibilitetit.....	19
6.2	Projektimi	19
6.3	Periudha e Punimeve të Rehabilitimit	19
6.4	Monitorimi dhe Mbikëqyrja.....	21
7.	FINANCIMI.....	21
8.	NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT.....	21
9.	SIGURIA DHE MBROJTJA.....	21
10.	MARRËVESHJET KONTRAKTUALE.....	21
10.1	Marrëveshjet Kontraktuale.....	21
10.2	Garancia e Përbushjes së Kontratës	22
11.	ZONA E KONCESIONIT	22
11.1	E Drejta e Përdorimit dhe Administrimit të Zonës së Koncesionit.....	22
11.2	Transferon të Drejtën e Përdorimit në Datën e Hyrjes në Fuqi.....	22
12.	OBJEKTET E REJA NË ZONËN E KONCESIONIT	23
13.	OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA.....	24
13.1	Operimi dhe Mirëmbajtja	24
14.	MARRJA NË DORËZIM E INVENTARIT TË AKTIVEVE TË HEKURUDHËS PAS VERIFIKIMIT FAKTIK.....	24
15.	TARIFAT E HEKURUDHËS DHE RISHIKIMI I PAVARUR EKONIMIK	24
15.1	Metodologjia e Përlllogarritjes së Tarifave të Përdoruesve të Tretë të Hekurudhës.....	25
15.2	Propozimi për Rishikimin Periodik i Tarifave të Hekurudhës	25
15.3	Deklarata e Rrjetit.....	25
16.	SIGURIMI I ASETETEVE	25

17.	PËRGJEGJËSITË DHE KUFIZIMI I PËRGJEGJËSIVE.....	26
17.1	Përgjegjësitë.....	26
17.2	Lehtësimi i Humbjes.....	26
18.	FORCA MADHORE	26
18.1	Raste të Forcës Madhore.....	26
18.2	Arsyetimi i përmbushjes së detyrimeve	27
18.3	Detyrimi për njoftimin e një Force Madhore	27
18.4	Detyrimi për ndreqjen e një Force Madhore.....	27
18.5	Shtyrja e Periudhës së Koncesionit për shkak të një Force Madhore.....	28
19.	NDËRHJRJA	28
19.1	E Drejta e Ndërhjrjes.....	28
20.	RASTE MOSPËRMBUSHJE TË DETYRIMEVE TË KONTRATËS	28
20.1	Mospërmbushjet e Shoqërisë Koncesionare	28
20.2	Pasojat e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare.....	29
20.3	Mospërmbushjet e Detyrimeve të Autoritetit Kontraktues.....	29
20.4	Pasojat e Mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktues	29
20.5	Të Drejta të Vecantë për Kompensimin (right to set-off).....	30
21.	ZGJIDHJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT	30
21.1	Zgjidhja pas Ndërhjrjes.....	30
21.2	Zgjidhja për shkak të një Force Madhore të Zgjatur.....	30
21.3	Zgjidhja nga Autoriteti Kontraktues për shkak të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare	30
21.4	Zgjidhja nga Shoqëria Koncesionare për shkak të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues	31
21.5	Mbijetesa pas Zgjidhjes.....	32
22.	PËRFAQËSIME DHE GARANCI.....	33
22.1	Autoriteti Kontraktues	33
22.2	Shoqëria Koncesionare	33
23.	TRANSFERIMI.....	34
24.	INSPEKTIMET	34
25.	TRANSFERIMI I TË DREJTAVE	34
25.1	Transferimi nga Shoqëria Koncesionare	34
25.2	Transferimi nga Autoritetit Kontraktues	34
26.	TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE	35
27.	KONFIDENCIALITETI	35
27.1	Qëllimi i Konfidencialitetit.....	35
27.2	Informacionet e lejuara për zbulim	35
28.	E DREJTA E NDËRHJRJES SË HUADHËNËSIT.....	35
28.1	E Drejta e Ndërhjrjes se Huadhënësit.....	35
29.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.....	36
29.1	Zgjidhja.....	36
29.2	Arbitrazhi	37
29.3	Masat paraprake.....	37
29.4	Detyrimi i Vazhdueshëm	37
30.	TË NDRYSHME.....	37
30.1	Marrëveshja e plotë	37
30.2	Njoftimet	37

30.3	Heqja dorë	38
30.4	Ndashmëria	38
30.5	Kopjet.....	38
30.6	Gjuha	38
30.7	Ndryshimet.....	39
30.8	Dokumentat shtesë dhe Veprimet	39
30.9	Heqja dorë nga Imuniteti Sovran.....	39
30.10	Ndryshimet në Ligj.....	39
31.	LEGJISLACIONI NË FUQI.....	39
	LISTA E SHTOJCAVE	41

Sot në Tiranë, më datë 04 Shkurt, viti 2016 (dy mijë e gjashtëmbëdhjetë), para meje noter Fatmir Laçej, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Pallati 203, Rruga e Kavajës, Tiranë, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, përfaqësuar nga ministri I Transportit dhe Infrastrukturës Z. Edmond Haxhinasto, më poshtë do të quhet **“AUTORITET KONTRAKTUES”**

DHE

SHOQËRIA KONCESIONARE “ALBRAIL” SH.P.K., e krijuar nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit më datë 14.01.2016 me seli në adresën: Godina 18/2, Rruga Nikolla Jorga, Njesia Bashkiake nr.7, Tiranë, me numër unik i identifikimit të subjektit NIPT: L61314003H, përfaqësuar nga administratori Z. Adrian Bedaj, shtetas shqiptar, i biri mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, më poshtë do të quhet **“SHOQËRIA KONCESIONARE”**

Si Autoriteti Kontraktor ashtu edhe Shoqëria Koncesionare do të referohen individualisht si **“Pala”** dhe bashkërisht si **“Palët”**.

DUKE PATUR PARASYSH SE:

- (A) Në zbatim të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, akteve nënligjore në fuqi, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si Autoritet Kontraktues në datën 2 Qershor 2015 ka publikuar dokumentat standardë të koncesionit të procedurës përzgjedhëse konkurruese “Për dhënien me koncesion të formës ROT për rehabilitimin, shfrytëzim dhe transferimin e rrjetit të transportit hekurudhor në linjat Fier – Ballsh dhe Fier – Vlorë” dhe ka ftuar operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre;
- (B) Bashkimi i operatorëve ekonomikë shoqëritë “Albstar” sh.p.k dhe “Matriks Konstruksion” sh.p.k paraqiti më datë 30.07.2015 në formë elektronike, një propozim në përgjigje të procedurës konkurruese në lidhje me “Për dhënien me koncesion të formës ROT për rehabilitimin, shfrytëzim dhe transferimin e rrjetit të transportit hekurudhor në linjat Fier – Ballsh dhe Fier – Vlorë”, propozim i cili pasi u trajtua u pranua nga Autoriteti;
- (C) Bashkimi i operatorëve ekonomikë shoqëria “Albstar” sh.p.k dhe “Matriks Konstruksion” sh.p.k u përzgjedh si fitues në fund të procesit të vlerësimit, si pasojë e përmbushjes së kërkesave të specifikuara në DSK, në përputhje me përcaktimet e bëra nga Autoriteti Kontraktues, sipas njoftimit të marre nga Shoqëria Koncesionare më datë 15 Shtator 2015;

- (D) Shoqëria Koncesionare është krijuar në përputhje me ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, si “subjekt për qëllime të veçanta” nga ortakët “Albstar” sh.p.k dhe “Matriks Konstruksion” sh.p.k;
- (E) Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në datën e nënshkimit nga Palët;
- (F) Si përfundim, Autoriteti Kontraktues dhe Shoqëria Koncesionare kanë hyrë në këtë Kontratë me qëllim për të vënë në zbatim koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara më poshtë:

Duke pasur në konsideratë detyrimet e parashikuara këtu e mëposhtë, Palët bien dakord si më poshtë:

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Përkufizime

Kurdo që përdoren në këtë Kontratë (përfshirë Shtojcat), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- 1.1.1 “*Autoriteti Kontraktues*” Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.
- 1.1.2 “*Aktivet në Transferim*” nënkupton pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Autoritetit Kontraktues të cilat do ti transferohen Autoritetit Kontraktues nga Shoqëria Koncesionare në Datën e Dorëzimit, në përputhje me Nenin 23 (*Transferimi*), aktive të tilla përfshijnë, pa kufizim, Zonën e Koncesionit, Objektet e Reja, dhe objektet dhe aktivet e tjera të lidhura me Koncesionin.
- 1.1.3 “*Autorizimet*” janë të gjitha, lejet, licencat, autorizimet, miratimet, vendimet ose çertifikatat që lidhen me zbatimin e Koncesionit, të cilat do t’i jepen Shoqërisë Koncesionare për efekt të këtij Koncesioni nga Autoriteti Kontraktues ose Organi Shtetëror përkatës pas Datës së Fillimit, sipas Nenit 2.3 (*Autorizimet*) renditur në Shtojcën 6 (*Autorizime*).
- 1.1.4 “*Aktivet Ekzistuese*” nënkupton aktivet e paluajtshme dhe të luajtshme të ndodhura në Zonën e Koncesionit, ekzistuese në Datën e Fillimit, (i) listuar në një listë inventari sipas Shtojcës 1 (*Aktivet Ekzistuese*) dhe transferuar në administrim dhe përdorim të Shoqëria Koncesionare në intervalet nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës deri në Datën e Fillimit të Periudhës Së Koncesionit.
- 1.1.5 “*Procesverbal i Përfundimit të Punimeve*” nënkupton një procesverbal të lëshuar nga Inxhinieri i Pavarur apo i Kualifikuar sipas Ligjit të Zbatueshëm pas përfundimit të çdo detyrimi Rehabilitues, siç zbatohet, në

përputhje me këtë Kontratë.

- 1.1.6 "Ditë Pune" është dita gjatë së cilës kryhet veprimtari tregtare në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të ditëve të pushimit kombëtar dhe të fundjavave.
- 1.1.7 "Data e Fillimit të Periudhës së Koncesionit" do të ketë kuptimin e përshkruar në Nenin 2.2 dhe nënkupton datën në të cilën Shoqëria Koncesionare është pajisur me të gjitha Autorizimet e nevojshme dhe ka marrë në dorëzim efektiv të gjithë Zonën e Koncesionit.
- 1.1.8 "Data e Miratimit të Pasqyrave Financiare" nënkupton miratimin e pasqyrave financiare për Vitin Financiar që përkon me Datën 31 Mars.
- 1.1.9 "Data e Dorëzimit" do të thotë data në të cilën skadon Periudha e Koncesionit ose datën e marrjes të një Njoftimi Përfundimi të dhënë siç duhet.
- 1.1.10 "Data e Kërkimit të Detyrimit" ka kuptimin, në lidhje me çdo Detyrim të atribuar palëve sipas kësaj Kontrate.
- 1.1.11 "Euro"ose "EUR" nënkupton monedhën e ligjshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që miratojnë monedhën e vetme, në përputhje me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, të ndryshuar nga Traktati mbi Bashkimin Evropian.
- 1.1.12 "Forca Madhore" do të thotë ndodhja e ndonjë rasti që kanë efektin dhe kuptimin e përshkruar në Nenin 18.1 (*Raste të Forcës Madhore*).
- 1.1.13 "Huadhënës" nënkupton çdo person fizik ose juridik i cili i jep hua Shoqërisë Koncesionare.
- 1.1.14 "Inxhinier i Pavarur" do të ketë kuptimin sipas Nenit 6.3 (*Periudha e Rehabilitimit*).
- 1.1.15 "Infrastrukturë Hekurudhore" është tërësia e të gjitha vijave hekurudhore, e degëzimeve hekurudhore, e pajisjeve dhe e instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizmit dhe elektrike, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe për sigurinë e trafikut.
- 1.1.16 "Interes Sigurimi" nënkupton çdo hipotekim, garanci, peng, barrë ose interes tjetër sigurimi të ndonjë lloji ose marrëveshje ose masë tjetër që ka efektin e dhënies së garancisë në lidhje me asete, të ardhura ose të drejta aktuale ose të ardhshme, duke përfshirë çdo përcaktim të personave të cilëve duhet t'u paguhet humbjet.
- 1.1.17 "Kontrata" dhe "Koncesion" nënkupton marrëveshjen e nënshkruar midis Shoqërisë Koncesionare dhe Autoritetit Kontraktues, duke pranuar kështu kushtet, të drejtat, detyrimet, shtojcat që do të bashkëlidhen me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë e

kësaj kontrate.

- 1.1.18 *"Kontraktorët e Shoqërisë Koncesionare"* nënkupton Personin e kontraktuar nga Shoqëria Koncesionare, ose një Person të nën-kontraktuar nga Personi i kontraktuar nga Shoqëria Koncesionare, me qëllim të rehabilitimit, administrimit, operimit dhe zhvillimit të Hekurudhës.
- 1.1.19 *"Kapitali i Shoqërisë"* do të thotë kuotat e paguara të kapitalit themeltar dhe/ose Hua i dhënë nga Ortakët ose Huadhënësi.
- 1.1.20 *"Ligji i Zbatueshëm"* nënkupton çdo ligj, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo rregullore, udhëzim, urdhër ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor.
- 1.1.21 *"Lek"* nënkupton monedhën e ligjshme të Republikës së Shqipërisë.
- 1.1.22 *"Mospërmbushja"* do të thotë dështimi e një pale në kryerjen e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, gjë e cila nuk vjen si rezultat as i Forcës Madhore.
- 1.1.23 *"Ndryshim i Vlefshëm"* do të thotë e drejta e Autoritetit Kontraktues për të kërkuar Shoqërisë Koncesionare ofrimin e punimeve dhe shërbimeve shtesë lidhur me Koncesionin, të cilat nuk përfshihen në objektin e Koncesionit.
- 1.1.24 *"Njoftim mbi Përfundimin"* nënkupton një njoftim me shkrim të dhënë në përputhje me këtë Kontratë që i jep fund kësaj Kontrate, njoftim i cili përcakton minimalisht arsyen mbi përfundimin.
- 1.1.25 *"Ndryshim në Ligj"* është miratimi, revokimi, ndryshimi ose shfuqizimi i ndonjë Ligji të Zbatueshëm në fuqi dhe veprim pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate.
- 1.1.26 *"Objekti Koncesionit"* Rehabilitimi i Infrastrukturës Hekurudhore, operimi si Administrues Infrastruktura dhe Transportues Hekurudhor i Integruar, të Rrjetit të Transportit Hekurudhor Fier – Balsh dhe Fier - Vlorë dhe transferimi i tij/tyre nga Shoqëria Koncesionare tek Autoriteti Kontraktues.
- 1.1.27 *"Objekte të Reja"* do të thotë objektet e reja që do të projektohen, ndërtohen, porositen, operohen dhe mirëmbahen nga Shoqëria Koncesionare në përputhje me Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*).
- 1.1.28 *"Okupimi"* nënkupton banimin ose çdo lloj tjetër okupimi ose posedimi të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme / ose nga palët e treta (duke përfshirë, pa kufizim, ish-pronarët) në pasuritë e paluajtshme në Zonën e Koncesionit, i cili (a)

është në kundërshtim me Ligjin e Zbatueshëm, dhe (b) ndikon në dëm të të drejtave të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate.

- 1.1.29 *"Periudha e Koncesionit"* ka kuptimin e përcaktuar asaj në Nenin 2.2 (*Kohëzgjatja*)
- 1.1.30 *"Periudha e Rehabilitimit"* do të thotë periudha kohore prej 46 muajsh e cila fillon në Datën e Fillimit të Periudhës së Koncesionit sipas nenit 2.2 (b) dhe mbaron në datën e përfundimit të investimit.
- 1.1.31 *"Projekti i Detajuar Teknik për Punimet e Rehabilitimit"* do të thotë projekti i detajuar teknik që do të projektohet nga projektuesi i cili hartohet duke u bazuar në një studim teknik të thelluar pas Hyrjes Në Fuqi të Kontratës në përputhje me Nenin 6.2.
- 1.1.32 *"Praktika e Industrisë së Mirë"* do të thotë standardet në lidhje me çështjet e mbuluara nga, praktikat, metodat, standardet dhe procedurat konform me Ligjin e Zbatueshëm dhe të ndjekura përgjithësisht në transportin dhe menaxhimin e industrisë së Hekurudhës në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit, e cila mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga operatorë të aftë të Rrjetit Hekurudhor dhe me përvojë, nën rrethana të njëjta ose të ngjashme.
- 1.1.33 *"Person"* nënkupton çdo person fizik, juridik, partneritet, sipërmarrje e përbashkët, shoqatë, organizatë, grup besimi, shtet, Autoritet Kontraktues, çdo ent shtetëror ose çdo agjenci, autoritet, bankë, parlament, Ministër, Ministri, zyrtar ose autoritet publik.
- 1.1.34 *"Projekt" dhe "Hekurudhë"* të dy termat "Projekt" dhe "Hekurudhë" nënkuptojnë rehabilitimi, vënia në punë, mirëmbajtja, operimi, administrimi dhe zhvillimi i segmentit të Infrastrukturës Hekurudhore Fier-Ballsh dhe Fier-Vlore, që përfshin, nder te tjera.
- 1.1.35 *"Përdoruesit e e Transportit Hekurudhor të Udhëtarëve"* nënkupton të gjitha pasagjerët që përdorin transportin Hekurudhor.
- 1.1.36 *"Transportuesit e Tjerë të Hekurudhës"* nënkupton palët e treta si Transportues Hekurudhor.
- 1.1.37 *"Studimi i Fizibilitetit"* nënkupton studimin paraprak teknik të propozuar nga Shoqëria Koncesionare i cili është subjekt ndryshimi si pasojë e Projektit të Detajuar Teknik për Punimet e Rehabilitimit me karakteristikat e përcaktuara në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*).
- 1.1.38 *"QKR"* Qendra Kombëtare e Regjistrimit në Tiranë e cila administron Regjistrin Shqiptar të Shoqërive.

- 1.1.39 *"Rishikim i Pavarur"* do të ketë kuptimin e dhënë atij në Nenin 15 (*Rishikimi i Pavarur Ekonomik*).
- 1.1.40 *"Subjekt për Qëllime të Veçanta (SPV)"* është një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të Autoritetit Kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet Kontrata.
- 1.1.41 *"Sigurimi i Performancës së Kontratës"* do të ketë kuptimin e përshkruar në Nenin 10.2 (*Sigurimi i Performancës së Kontratës*).
- 1.1.42 *"Subjekt Shtetëror"* Subjekt shtetëror ose autoritet administrativ, civil ose ushtarak të Autoritetit Kontraktues ose nënndarje administrative të Autoritetit Kontraktues, duke përfshirë pa kufizim, Qeverinë e Shqipërisë dhe çdo organ qeveritar vendor dhe çdo organizatë publike ose subjekt tjetër të zotëruar ose të kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ose që operon për llogari ose interes të ndonjë prej një ose më shumë agjencive të Autoritetit Kontraktues.
- 1.1.43 *"Standarte"* nënkupton rregulloret dhe/ose standardet (duke përfshirë pa kufizim, çdo praktikë dhe/ose procedurë të rekomanduar të përfshirë në këto rregullore dhe/ose standarde) herë pas here të zbatueshme në lidhje me ndonjë aspekt të Koncesionit.
- 1.1.44 *"Shmangiet e Pranuara"* janë shmangiet nga kushtet dhe afatet e Koncesionit, të pranuar me shkrim herë pas here ndërmjet Shoqërisë dhe Autoritetit Kontraktues.
- 1.1.45 *"Shkelje Thelbësore"* do të kenë kuptimin e dhënë në Nenin 20.5 (*Shkelje Thelbësore*) dhe u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.
- 1.1.46 *"Shpronësim i Detyrueshëm i Tokës"* do të thotë shpronësimi nga Autoriteti Kontraktues në kohët përkatëse për Projektin të përcaktuar në Shtojcën 7 (*Zona e Koncesionit*).
- 1.1.47 *"Shërbime"* nënkupton të gjitha shërbimet në Zonën e Koncesionit.
- 1.1.48 *"Të Drejta të Pronësisë Intelektuale"* nënkupton të gjitha patentat, të drejtat e projektimit, të drejtat e autorit, markat tregtare, markat e shërbimit, emrat tregtare dhe të gjitha të drejtat e tjera të pronës intelektuale të çfarëdo natyre në të gjithë botën, të regjistruara ose të paregjistruara dhe duke përfshirë të gjitha aplikacionet.

- 1.1.49 "Tarifat e Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës" nënkupton tarifat e të tretëve të përcaktuara sipas Shtojcës 3 (Metodologjia e Përlllogaritjes së Tarifave të Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës).
- 1.1.50 "Transportues Hekurudhor i Integruar" është një transportues hekurudhor, që është edhe një administrues infrastrukture.
- 1.1.51 "Tarifa e Koncesionit" do të thotë tarifa që do të paguhet nga Shoqëria Koncesionare për Autoritetin Kontraktues e përcaktuar në Nenin 5.1.
- 1.1.52 "Viti Financiar" nënkupton periudhën që fillon çdo vit më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor.
- 1.1.53 "Zona e Koncesionit" do të thotë zona, një hartë e cila përcaktohet në Shtojcën 7 (Zona e Koncesionit) dhe e cila tregon zonën e mbuluar nga Koncesioni.

1.2 Interpretimi

- (a) Në këtë Kontratë, përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe:
- (i) "një "muaj" është referencë ndaj një periudhe që fillon në një ditë në një muaj kalendarik dhe që përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në muajin e ardhshëm kalendarik, me përjashtim të rastit nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në muajin në të cilin përfundon ajo periudhë, ajo periudhë do të përfundojë ditën e fundit në atë muaj kalendarik;
 - (ii) një "Palë" i referohet Shoqërisë Koncesionare ose Autoritetit Kontraktues, sipas rasteve të zbatueshme; dhe
 - (iii) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas. Referimi të njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër.
 - (iv) referimi të një akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor përfshin referim tek ai akt ligjor, dispozitë statutore apo instrument statutor siç është ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohë pas kohe, si dhe të çdo rregullore e nxjerrë në bazë e për zbatim të tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, shtese apo rimiratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenet e kësaj Kontrate. Për shmangien e dyshimit, kjo nuk cenon të drejtat e Shoqërisë Koncesionare sipas Nenit 30.11 (Ndryshim në Ligj).
 - (v) një Personi përfshin pasardhësit e tij dhe drejtëmarrësit ose marrësit e autorizuar;
 - (vi) çdo Neni, paragrafi ose Shtojce, përveç kur deklarohet shprehimisht për të kundërtën, është referencë ndaj atij Neni, paragrafi ose Shtojce të kësaj Kontrate;

- (vii) kjo Kontrate ose ndonjë dokument tjetër përfshin një referencë ndaj çdo ndryshimi/amendimi të autorizuar ose shtesë të kësaj Kontrate, ndryshuar herë pas here;
- (viii) kjo Kontrate përfshin edhe Shtojcat e saj; dhe
- (b) Nëse konteksti kërkon që fjalët që shprehin numrin njëjës do të përfshijnë shumësin dhe *anasjelltas*.
- (c) Titujt dhe renditja numerike e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.
- (ç) Një referim te secili organ është nëse ai organ:
 - (i) zëvendësohet nga një organizëm tjetër, vlerësohet se i referohet asaj organizate; dhe
 - (ii) pushon së ekzistuari, vlerësohet se i referon organizatës që më afër ose në shkallën më të madhe shërben për të njëjtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.
- (d) Në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të pjesës kryesore të Kontratës, të ndonjë Shtojce ose Studimi i Fizibilitetit do të ketë.

1.3 Objekti Koncesionit

- (a) Me anën e kësaj Kontratë, Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Ligji i Zbatueshëm, jep me koncesion Infrastrukturën Hekurudhore Fier - Ballsh, Fier – Vlorë sipas Nenit 2.1 mëposhte, brenda një kuadri bashkëpunimi reciprok dhe të ngushtë ndërmjet Palëve dhe përcakton tërësinë e të drejtave e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues dhe Shoqërisë Koncesionare, si dhe përcakton tërësinë e shërbimeve, detyrimeve që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e Kontratës.
- (b) Forma e Kontratës së Koncesionit është “rehabilitim, operim dhe transferim” në pronësi të shtetit (Rehabilitate-Operate-Transfer/ROT).

2. DHËNIA, PERIUDHA DHE AUTORIZIMET E KONCESIONIT

2.1 Dhënia e Koncesionit

Konform kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep Shoqërisë Koncesionare me koncesion të formës ROT (rehabilitim, operim dhe transferim) të drejta të vetme gjatë Periudhës së Koncesionit për realizimin e Projektit në Zonën e Koncesionit dhe, në veçanti, të drejta për të:

- (i) rehabilituar Infrastrukturën Hekurudhore, operuar si Administrues Infrastrukture dhe Transportues Hekurudhor i Integruar, vënë në funksionim dhe mirëmbajtur godina, infrastrukturën dhe shërbimet publike të Infrastrukturës Hekurudhore Fier – Balsh dhe Fier - Vlorë

dhe të gjitha ambientet e tjera të përcaktuara në Zonën e Koncesionit.

- (ii) mbledhur pagesat e Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës gjatë Periudhës së Koncesionit.

2.2 Periudha e Koncesionit

- (a) Autoriteti Kontraktues i jep Shoqërisë Koncesionare Koncesionin për një periudhë prej 25 vjet ("Periudha e Koncesionit").
- (b) Data e Fillimit të Periudhës së Koncesionit konsiderohet data më e fundit e plotësimit të pikave (i) dhe (ii) mëposhtë por në asnjë rast të mos kalojë periudhën prej 28 muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi:
 - (i) pas marrjes e të gjitha Autorizimeve për të realizuar këtë Koncesion sipas Nenit 2.3 renditur në Shtojcën 7 (*Autorizime*); dhe
 - (ii) pas marrjes në dorëzim të gjithë Aktiveve Ekzistuese në Zonën e Koncesionit që janë të lira nga çdo Okupim përfshi këtu depozitimin e Kontratës së Koncesionit për aplikim në zyrat vendore të rregjistrimit të pasurive të paluajtshme e shoqëruara me planet e rilevimit përkatëse që rregjistrojnë të drejtat e përdorimit të pasurive të paluajtshme në Zonën e Koncesionit për llogari të Shoqërisë Koncesionare. Autoriteti njofton me shkrim Shoqërinë Koncesionare se Autoriteti Kontraktues ka liruar nga Okupimi i ligjshëm dhe i paligjshëm të gjithë pasuritë e paluajtshme të ndodhura në Zonën e Koncesionit dhe ja dorëzon Shoqërisë Koncesionare për të ushtruar të drejtat që ja jep kjo Kontratë sipas Shtojcës 5 (*Forma E Procesverbalit Nga Autoriteti Kontraktues Dhe Shoqëria Koncesionare Që Konfirmon Se Pasuritë E Paluajtshme Në Zonën E Koncesionit Janë Të Lira Nga Okupesit Ose Të Drejta Të Tjera Të Ushtrueshme Nga Palë Të Treta*);
- (c) Periudha e Koncesionit mund të zgjatet me plotësimin e përcaktimeve të Ligjit të Zbatueshëm *ndër të tjera*:
 - (i) me dakortësinë me shkrim të Palëve në cdo rast në masën maksimale të lejueshme sipas Ligjit të Zbatueshëm; ose
 - (ii) nga një periudhë e Forcës Madhore që tejkalon dy muaj, në përputhje me Nenin 18.5 (*Shtyrja e Periudhës së Koncesionit për shkak të një Force Madhore*); ose
 - (iii) në kohën e kërkuar për realizimin e Ndryshimit të Pranueshëm të dakortësuar ndërmjet Palëve.
- (d) Jo më parë se përvjetori i 7-të ose përvjetori i 15-të i Datës së Hyrjes në Fuqi dhe jo më vonë se 12 muaj para përfundimit të Periudhës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues ose Shoqëria Koncesionare, me anë të një njoftimi me shkrim prej njëres nga palët, mund të fillojë procesin e negociimit mbi çështjen e shtyrjes së periudhës për të cilën është dhënë

fillimisht Koncesioni. Për shmangien e dyshimit Periudha e Koncesionit nuk do të jetë më shumë se 35 vjet.

2.3 Autorizimet

- (a) Autoriteti Kontraktues ose çdo Subjekt Shtetëror nën autoritetin e drejtpërdrejtë të tij garanton se pas Datës së Hyrjes në Fuqi, do t'i lëshojë Shoqërisë Koncesionare Autorizimet, *me kusht që*:
- (i) këto Autorizime të kërkohen për ushtrimin nga Shoqëria Koncesionare të të drejtave të saj dhe përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate;
 - (ii) lëshimi i këtyre Autorizimeve të jetë brenda sferës së kompetencës së Autoritetit Kontraktues ose kompetencës të Subjektit Shtetëror përkatës;
 - (iii) lëshimi i këtyre Autorizimeve të jetë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm; dhe
 - (iv) Shoqëria Koncesionare t'i ketë paraqitur Autoritetit Kontraktues ose Subjektit Shtetëror përkatës, sipas rastit, informacion të plotë (duke përfshirë dokumentacionin) që mbështet kërkesën e tij për Autorizimin përkatës.
- (b) Në masën që Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të lëshojë Autorizime, Autoriteti Kontraktues do të bëjë përpjekje maksimale për të asistuar që Autorizimet përkatëse t'i lëshohen Shoqërisë Koncesionare në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm dhe pa vonesë të paarsyeshme, pas një kërkesë të paraqitur sipas rregullave nga Shoqëria Koncesionare.
- (c) Autoriteti Kontraktues do të bëjë përpjekjet e duhura brenda mundësive dhe kompetencave të tij me qëllim që:
- (i) të gjitha Subjektet Shtetërore që ushtrojnë kompetencat e tyre përkatëse në lidhje me Koncesionin, do të informohen sipas rregullave rreth ekzistencës së kësaj Kontrate, dhe
 - (ii) sipas gjendjes dhe në masën që Autoriteti Kontraktues ushtron autoritet të drejtpërdrejtë ndaj tyre, të gjitha Subjektet Shtetërore që ushtrojnë kompetencat e tyre përkatëse në lidhje me Koncesionin, pa vonesë të paarsyeshme, do të bashkëpunojnë me Shoqërinë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Projektit.

3. DATA E HYRJES NË FUQI TË KONTRATËS

Kjo Kontratë hyn në fuqi me efekt të plotë pas nënshkrimit të saj nga Palët.

4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË KONCESIONARE

4.1 Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare

Përveç të drejtave të tjera që lindin nga dhënia e Koncesionit sipas Ligjit të Zbatueshëm, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë:

- (a) të rekrutojë ose angazhojë ata Persona që Shoqëria Koncesionare mund të konsiderojë të nevojshëm për të ofruar konsulencë në lidhje me projektimin, rehabilitimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen, operimin, administrimin dhe zhvillimin e Hekurudhës, duke përfshirë kontabilistë, inxhinierë, avokatë dhe profesionistë dhe specialistë të tjerë;
- (b) të caktojë politikën e vet të punësimit, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm;
- (c) të realizojë ato akte të tjera që i çmon të nevojshme që Shoqëria Koncesionare të realizojë Projektin për të përmbushur detyrimet dhe për të ushtruar të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate;
- (ç) të kërkojë kompensim nga Autoriteti Kontraktues për kostot financiare të ardhura si pasojë e vonesës nga heqja dhe zhvendosja e okupesve të paligjshëm në Zonën e Koncesionit;
- (d) t'i jepet një zgjatje kohore e barabartë me çdo periudhë vonese në lidhje me zbulimet dhe/ose kërkimet arkeologjike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Subjekt Shtetëror në Zonën e Koncesionit që cenon përmbushjen nga Shoqëria Koncesionare të ndonjë prej Detyrimeve të Rehabilitimit.
- (dh) t'i jepet një shtyrje e Datës së Kërkuar të Detyrimit nga periudha e vonesës në përmbushjen e Detyrimeve të Rehabilitimit të shkaktuara nga Ndryshimi i Pranueshëm.
- (e) nëse Autoriteti Kontraktues ka dështuar në lirimin e Zonës së Koncesionit, të kompensojë/dëmshpërblejë Okupesit, në bazë të legjislacionit për shpronësimin publik në fuqi, nëpërmjet akteve noteriale që ndodhen në Zonën e Koncesionit dhe ka të drejtën ta konsiderojë këtë shumë si pjesë e investimit.

4.2 Detyrimet e Përgjithshme të Shoqërisë Koncesionare

Shoqëria Koncesionare:

- (a) përmbush dhe mbulon të gjitha kostot dhe shpenzimet e shoqëruara me plotësimin e Detyrimeve të Rehabilitimit, në përputhje me këtë Kontratë, Ligjin e Zbatueshëm dhe Praktikën e Mirë Industriale;
- (b) aplikon, paguan, merr dhe mban të gjitha Autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- (c) garanton se personat e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues do të kenë akses në Zonën e Koncesionit sipas një njoftimi paraprak nga Autoriteti

Kontraktues te Shoqëria Koncesionare, në bazë të përputhshmërisë me standardet e zbatueshme të sigurisë të përcaktuara në Ligjin e Zbatueshëm dhe në këtë Kontratë;

- (ç) e mban të sigurt në çdo kohë Zonën e Koncesionit gjatë Periudhës së Koncesionit, duke përfshirë pa kufizim, sigurimin dhe pajisjen e personelit të sigurisë për këtë qëllim;
- (d) përgatit dhe i jep Autoritetit Kontraktues informacionin dhe dokumentacionin e përcaktuar në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*). Përveç kësaj, Shoqëria Koncesionare i paraqet Autoritetit Kontraktues ose Subjektit Shtetëror përkatës ato raporte që kërkohen në këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm, në kohët e kërkuara dhe në mënyrat e kërkuara ndërsa këto mënyra bien dakord paraprakisht ndërmjet Palëve. Shoqëria Koncesionare i përgjigjet pyetjeve të arsyeshme të Autoritetit Kontraktues ose Subjektit Shtetëror përkatës në lidhje me këto raporte. Të gjitha raportimet, njoftimet dhe përgjigjet e kërkuara do të jepën brenda afateve të arsyeshme kohore të nevojshme për përgatitjen e tyre, siç do të bihet dakort mes Palëve;
- (dh) është përgjegjës për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e ambienteve të ndërtuara ose të riparuar nga Shoqëria Koncesionare në lidhje me Projektin, duke përfshirë të gjitha strukturat që formojnë pjesë të tij dhe pajtueshmërinë e tyre me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë;
- (e) bashkëpunon me Autoritetin Kontraktues në interes të zbatimit të duhur të Projektit;
- (ë) do t'i japi akses në Infrastrukturën e Hekurudhës në cilësinë e Administruesit të Infrastrukturës Transportuesve Hekurudhorë konform pagesës së Tarifës për Transportuesit e Tjerë të Hekurudhës sipas Ligjit të Zbatueshëm;
- (f) bashkëpunon me Inxhinierin e Pavarur dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit, siç ata mund të kërkojnë për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Kontrate;
- (g) konfirmon te Autoriteti Kontraktues se Shoqëria është themeluar sipas rregullave në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe këtë Kontratë dhe është autorizuar sipas rregullave për të lidhur këtë Kontratë;

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

5.1 E Drejta e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marri pagesën e Tarifës së Koncesionit, sipas percaktimit në ofertën e Shoqërisë Koncesionare si mëposhtë:

- (a) **Tarifa e Koncesionit:** Shoqëria Koncesionare do t'i paguajë çdo vit Autoritetit Kontraktues një tarifë që arrin shumën prej 2.2 (dy pikë dy) për qind të të Ardhurave Bruto në bazë të kushteve të përcaktuara mëposhtë. Në fund të Periudhës së Koncesionit ose në rast të një përfundimi të parakohshëm të kësaj Kontrate nga palët, pagesa e fundit e Tarifës së Koncesionit do të llogaritet duke marrë parasysh të Ardhurat Bruto të mbledhura deri në atë datë.

- (b) **Pagesa:** Tarifa e Koncesionit paguhet nga Shoqëria Koncesionare te Autoriteti Kontraktues me prioritet ndaj shpërndarjes së dividendëve për Ortakët e Shoqërisë Koncesionare. Data e pagesës për cdo vit është 30 ditë pas Datës së Miratimit të Pasqyrave Financiare. Kjo datë do të shtyhet, nëse kërkohet, në masën e nevojshme për të mundur kohën e arsyeshme për Shoqërinë Koncesionare që të shpallë dhe miratojë pagesën e dividendit (në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe Dokumentet e Financimit) që korrespondon me pagesën e shumës përkatëse të Tarifës së Koncesionit.

5.2 Detyrimet e Përgjithshme të Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues (dhe/ose çdo subjekt shtetror nën autoritetin e drejtpërdrejtë të tij) garanton dhe ka detyrimin që:

- (a) t'i japi Shoqërisë Koncesionare të dhëna dhe informacione që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate dhe/ose që kërkohen për qëllim të menaxhimit, operimit dhe zhvillimit të Projektit dhe do të informojë Shoqërinë Koncesionare në lidhje me ndryshimet ose shtesat në to dhe do t'i japë një kopje te Shoqëria Koncesionare për këto të dhëna ose informacione kur dhe nëse kërkohen në mënyrë të arsyeshme;
- (b) t'i japi të gjitha të drejtat e përdorimit dhe administrimit mbi të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Zonën e Koncesionit gjatë Periudhës së Koncesionit;
- (c) t'i japi Shoqërisë Koncesionare, sipas kërkesës nga Shoqëria Koncesionare, pa vonesë të paarsyeshme, çdo informacion, dokumente dhe të dhëna në lidhje me ose të lidhura me Projektin që Autoriteti Kontraktues ka në zotërim dhe që Shoqëria Koncesionare kërkon në mënyrë që të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate;
- (ç) të bëjë përpjekjet e duhura brenda mundësive dhe kompetencave të tij për të siguruar që asnjë Subjekt Shtetëror të mos marrë masa në mënyrë abuzive dhe në kundërshtim me Ligjin e Zbatueshëm të cilat do të sillnin pasoja negative në objektin e Koncesionit;
- (d) të bashkëpunojë në përgjithësi me Shoqërinë Koncesionare në mirëbesim, në interes të zbatimit të Projektit;
- (dh) nuk duhet të ndërpresë rehabilitimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen, operimin dhe administrimin e Infrastrukturës Hekurudhore nga Shoqëria Koncesionare përvec rasteve të parashikuara në këtë Kontratë;
- (e) nuk do të lëshojë asnjë autorizim për përdorimin, ndërtimin ose ngritjen e ndonjë godine ose strukture në Zonën e Koncesionit;
- (ë) konfirmon që përfaqësimet dhe garancitë e Autoritetit Kontraktues sipas kësaj Kontrate janë të vërteta dhe të drejta në të gjitha aspektet thelbësore në Datën e Hyrjes në Fuqi;
- (h) t'i sigurojë vazhdimësinë në objektin e Kontratës, pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtare dhe të sektorit;

- (j) se nuk hyn ose nuk synon të hyjë në ndonjë marrëveshje të çfarë do lloj natyre me palë të treta që japin ose synojnë të japin ndonjë nga të drejtat sipas Koncesionit (dhe veçanërisht të drejtat e identifikuar në Nenin 2.1 (*Dhënia e Koncesionit*) një pale të tretë duke përfshirë lidhjen e kontratave që mund të ndikojnë negativisht tek të drejtat e vetme të dhëna te Shoqëria Koncesionare sipas kësaj Kontrate;
- (k) t'i garantojë Shoqërisë Koncesionare të drejtën e vetme si Administrator i Infrastrukturës Hekurudhore sipas Ligjit të Zbatueshëm në objektin e Kontratës;
- (l) të garantojë se Zona e Koncesionit që zotërohet nga Autoriteti Kontraktues drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet ndonjë Subjekti Shtetëror gjatë Periudhës së Koncesionit do të jenë të lira nga ndonjë Okupues, Interes Sigurimi, detyrim, qera, barrë, pretendim i ish pronarëve dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga palë të treta. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues garanton se do ndërmarri lirim të trasesë nga vagonat stok, të dëmtuar, jo-funksional;
- (ll) nëse ka, menjëherë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, t'i dorëzojë Shoqërisë Koncesionare kopje të të gjitha llogarive, faturave, deklaratave, kërkesave, njoftimeve dhe çdo korrespondence që mund të jetë në zotërimin e tyre në lidhje me Projektin;
- (m) nëse ka, t'i japë Shoqërisë Koncesionare, gjatë Periudhës së Koncesionit, të gjithë informacionin që zotëron, konsulencën dhe asistencën që Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë në lidhje me aplikimin për dhënie të të gjitha Autorizimeve që mund të kërkojnë për operimin e Projektit;
- (n) nëse ka, t'i japë Shoqërisë Koncesionare kopje të këtij informacioni, dokumenteve dhe të dhënave në lidhje me Projektin, që ka në zotërim dhe që Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;
- (nj) do të asistojë Shoqërinë Koncesionare për marrjen e të drejtave të përdorimit të kësaj prone të paluajtshme (duke përfshirë ushtrimin e kompetencave për të marrë në mënyrë të detyrueshme ose shpronësuar këtë prone të paluajtshme); dhe
- (o) për rastet e Detyrimit të Subvencionimit të Sherbimit Publik nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka detyrim të kompensojë Koncesionarin në fund të çdo Viti Financiar nëpërmjet një marrëveshjeje midis Palëve.

Nëse një Detyrim nuk plotësohet para ose në një datë të tillë Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit, në Ditën e parë të Punës të çdo muaji, shumën e penaltetit për ditë, për mospërmbushje të një Detyrimi të vendosur në Shtojcën 2 (*Penalitetet në Rast të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare dhe Autoriteti Kontraktues*).

6. PUNIMET E REHABILITIMIT

6.1 Studimi i Fizibilitetit

- (a) Shoqëria Koncesionare garanton se Punimet e Rehabilitimit dhe vënia në funksionim e Infrastrukturës Hekurudhore duke përfshirë çdo Ndryshim të Pranueshëm, dhe të gjitha punimet, materialet, pajisjet, sistemet dhe procedurat e përfshira në lidhje me to, duhet të jenë në përputhje me Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*), Standardet e Praktikës së Mirë si dhe Ligjin e Zbatueshëm.
- (b) Studimi i Fizibilitetit nuk mund të ndryshohet, modifikohet ose devijohet përveçse me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve, pas një rekomandimi përkatës të këtij ndryshimi, modifikimi ose devijimi të propozuar nga Palët.

6.2 Projektimi

- (a) Shoqëria Koncesionare merr përsipër të:
 - (i) hartojë Projektin e Detajuar Teknik për të realizuar punimet rehabilituese të Infrastrukturës Hekurudhore duke u bazuar te fizibiliteti në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*) dhe nevojat e tjera për të arritur qëllimin e synuar në këtë Kontratë;
 - (ii) mirëmbajë Zonën e Koncesionit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*);
 - (iii) bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.
- (b) Shoqëria Koncesionare do të ketë pronësi të plotë dhe pa pengesa të Drejtave të Pronësisë Intelektuale për skicat e projektit dhe për materiale dhe dokumente të tjera të hartuara nga ose në emër të Shoqëria Koncesionare për qëllime të Projektit ose do të ketë një licencë të përhershme pa pagesë tarifash, jo-ekskluzive dhe të transferueshme, duke patur të drejtën e dhënies së nënlicencave dhe për të kopjuar, riprodhuar, modifikuar, përkthyer dhe përdorur të gjitha këto skica projekti, materiale dhe dokumente për ndonjë qëllim të lidhur me Projektin.

6.3 Periudha e Punimeve të Rehabilitimit

- (a) Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për realizimin dhe përfundimin e Punimeve të Rehabilitimit dhe do të marrë përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet e lidhura me Punimet e Rehabilitimit në përputhje me këtë Kontratë.
- (b) Periudha e Punimeve të Rehabilitimit do të jetë 46 muaj dhe fillon:
 - (i) pas marrjes e të gjitha Autorizimeve për të realizuar këtë Projekt sipas Nenit 2.3 renditur në Shtojcën 7 (*Autorizime*); dhe
 - (ii) pas marrjes në dorëzim të gjithë Aktiveve Ekzistuese në Zonës e Koncesionit sipas Nenit 14 përfshi këtu edhe miratimin e Vendimit të

Keshillit të Ministrave që i jep Shoqërisë Koncesionare të drejtat e përdorimit të pasurive të palujtshme në Zonën e Koncesionit.

Koncesionari mund të tejkalojë periudhën e mësipërme për shkaqe të arsyeshme me miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.

- (c) Për Punimet e Rehabilitimit, detyrimet e Shoqërisë Koncesionare, *ndër të tjera*, përfshijnë:
- (i) realizimin, përfundimin dhe vënien në funksionim të Punimeve të Rehabilitimit në përputhje me:
 - (1) Ligjin e Zbatueshëm dhe të gjitha Autorizimet e kërkuara;
 - (2) Praktikën e Mirë Industriale;
 - (3) të gjitha kërkesat e tjera të kësaj Kontrate, duke përfshirë, Projektin e Detajuar Teknik;
 - (ii) organizimin e Zonës së Koncesionit gjatë periudhës së rehabilitimit, duke marrë parasysh masat e sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, sigurinë, transportin, dorëzimin e mallrave, impianteve dhe pajisjeve, kontrollin e ndotjes, mbajtjen e personelit kompetent dhe fuqisë punëtore dhe marrëdhëniet industriale dhe shërbimet e përgjithshme, duke përfshirë, pa kufizim, kërkesën që Kontraktuesit e Shoqërisë Koncesionare të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të garantuar siguri në metodat dhe aktivitetet e tyre të ndërtimit, me qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit;
 - (iii) garancinë se Punimet e Rehabilitimit dhe punime të tjera do të përfshijnë vetëm materiale dhe mallra sipas Ligjit të Zbatueshëm dhe në përputhje me këtë Kontratë;
 - (iv) nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, kërkimin dhe marrjen (me ndihmën dhe bashkëpunimin e Autoritetit Kontraktues) në kohë dhe më pas mbajtjen e të gjitha Autorizimeve përkatëse të kërkuara për zbatimin e Projektit dhe të kësaj Kontrate.
- (ç) Brenda 90 ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi, Shoqëria Koncesionare propozon të Autoriteti Kontraktues një kandidat për Inxhinier të Pavarur dhe Autoriteti Kontraktues jep pëlqimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Shoqëria Koncesionare garanton se Inxhinieri i Pavarur do të lidhë një marrëveshje shërbimi me Shoqërinë Koncesionare, në përputhje me përmbledhjen e objektit të shërbimeve që duhet të kryhen nga Inxhinieri i Pavarur, të përcaktuara në Shtojcën 4 (*Inxhinieri i Pavarur*).
- Nëse ndonjë Palë ka mosmarrëveshje në lidhje me ndonjë informacion të dhënë nga Inxhinieri i Pavarur, kjo do të zgjidhet në përputhje me Nenin 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).
- (d) Shoqëria Koncesionare i jep Autoritetit Kontraktues (nëpërmjet Inxhinierit të Pavarur) informacionin dhe dokumentet e përcaktuara në të këtë Kontrate dhe Shtojcën 4 (*Inxhinieri i Pavarur*).

6.4 Monitorimi dhe Mbikëqyrja

Gjatë periudhës së kryerjes së Punimeve të Rehabilitimit (duke përfshirë punimet përkatëse përgatitore), Inxhinieri i Pavarur do të monitorojë dhe mbikëqyr përputhshmërinë e Punimeve të Rehabilitimit me këtë Kontratë dhe kryerjen e inspektimeve të Punimeve të Rehabilitimit dhe punimeve të tjera në prani të një përfaqësuesi të Shoqërisë Koncesionare. Inxhinieri i Pavarur garanton se ky monitorim dhe këto inspektime nuk ndërhyjnë në progresin e punimeve të rehabilitimit.

7. FINANCIMI

Shoqëria Koncesionare merr masa për financim të mjaftueshëm, për qëllim të realizimit të Projektit dhe përmbushje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

8. NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Njësia e Zbatimit të Projektit caktohet nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, për qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Projektit.

9. SIGURIA DHE MBROJTJA

- (a) Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për sigurinë në Zonën e Koncesionit dhe Shoqëria Koncesionare do të respektojë procedurat dhe funksionet e përshkruara në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*).
- (b) Në rast se Shoqëria Koncesionare nënkontraktton realizimin e aktiviteteve të sigurisë dhe/ose mbrojtjes në Zonën e Koncesionit, Shoqëria Koncesionare do të veprojë në përputhje të plotë me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm. Shoqëria e përzgjedhur nga Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për aplikimin, marrjen dhe mbajtjen e të gjitha autorizimeve, aprovimeve dhe miratimeve të kërkuara për realizimin e aktiviteteve të saj të sigurisë dhe mbrojtjes.
- (c) I gjithë personeli i angazhuar në aktivitetet e sigurisë dhe mbrojtjes dhe personeli i angazhuar për sigurinë i nënshtrohen procedurave të veçanta të rekrutimit që duhet të ndërmerren në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm. Asnjë person ose nënkontraktues nuk do të ndërmarrë aktivitete sigurie dhe/ose mbrojtje në Zonën e Koncesionit, pa pëlqimin paraprak të Shoqëria Koncesionaret dhe në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligj të Zbatueshëm.

10. MARRËVESHJET KONTRAKTUALE

10.1 Marrëveshjet Kontraktuale

Shoqëria Koncesionare lidh ato kontrata dhe marrëveshje që mund të jenë të nevojshme për të garantuar ushtrimin e të drejtave të tij dhe përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

10.2 Garancia e Përbushjes së Kontratës

- (a) Shoqëria Koncesionare ofron Garanci për Përbushjen e Kontratës në masën 10% të vlerës së investimit të përshkallëzuar vit pas viti sipas investimit të realizuar dhe e rinovueshme çdo vit. Kjo Garanci do mbulojë periudhën nga Data e Nënshkrimit deri në përfundim të Punimeve të Rehabilitimit prej 46 muaj sipas Studimit të Fizibilitetit dhe do të jetë e kërkueshme nga Autoriteti Kontraktues nëse nuk realizohen Punimet e Rehabilitimit.
- (b) Shoqëria Koncesionare ofron Garanci për Përbushjen e Kontratës, në masën 2%, të vlerës së investimit në pajisje sipas shkallës së amortizimit dhe e rinovueshme çdo vit. Kjo Garanci do mbulojë periudhën pas Punimeve të Rehabilitimit deri në përfundim të Periudhës së Koncesionit dhe do të jetë e kërkueshme nga Autoriteti Kontraktues në një Rast i Paafëtisë Pagueuse ka ndodhur në lidhje me Shoqërinë Koncesionare dhe rrjedhimisht Shoqëria Koncesionare nuk ka aftësi pagueuse.

11. ZONA E KONCESIONIT

11.1 E Drejta e Përdorimit dhe Administrimit të Zonës së Koncesionit

Në bazë të Nenit 2.1 (*Dhënia e Koncesionit*) nga Data e Hyrjes në Fuqi, Shoqëria Koncesionare, për qëllim dhe brenda kuadrit të kësaj Kontrate, do të ketë të drejtën e vetme të përdorimit dhe administrimit të pasurive të palujtshme në Zonën e Koncesionit gjatë Periudhës së Koncesionit.

11.2 Transferon të Drejtën e Përdorimit në Datën e Hyrjes në Fuqi

- (a) Në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues transferon të drejtën e përdorimit të Shoqëria Koncesionare për pasuritë e palujtshme dhe të palujtshme të ndodhura në Zonën e Koncesionit sipas Shtojcës 1 (*Inventari Ekzistues i Aktiveve*).
- (b) Pas Datës së Hyrjes në Fuqi Shoqëria Koncesionare depoziton Kontratën e Koncesionit për aplikim në zyrat vendore të rregjistrimit të pasurive të palujtshme të cilat janë të lira nga çdo lloj forme Okupimi, Interes Sigurimi, detyrim, qera, barrë dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga palë të treta duke e shoqëruar aplikimin me planet e rivevimit përkatëse. Zyrat vendore të pasurive të palujtshme rregjistrojnë të drejtat e përdorimit të pasurive të palujtshme në Zonën e Koncesionit për llogari të Shoqërisë Koncesionare. Shpenzimet e akumuluar për këtë proces do të mbulohen nga Shoqëria Koncesionare dhe do të përlloragiten si pjesë e investimit.
- (c) Autoriteti Kontraktues garanton se pasuritë e palujtshme në Zonën e Koncesionit që zotërohet nga Autoriteti Kontraktues drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet ndonjë Subjekti Shtetëror, gjatë Periudhës së Koncesionit do të jenë të lirë nga ndonjë Okupim, Interes Sigurimi, detyrim, qera, barrë dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga palë të treta.
- (ç) Nëse Shoqëria Koncesionare evidenton raste të tilla atëherë Autoriteti Kontraktues merr masat e menjëhershme për lirimin e tyre dhe njofton me shkrim Shoqërinë Koncesionare se Autoriteti Kontraktues ka liruuar nga

Okupimi i ligjshëm dhe i paligjshëm të gjithë pasuritë e palujtshme të ndodhura në Zonën e Koncesionit dhe ja dorëzon Shoqërisë Koncesionare për të ushtruar të drejtat që ja jep kjo Kontratë sipas Shtojcës 5 (*Forma E Procesverbalit Nga Autoriteti Kontraktues Dhe Shoqëria Koncesionare Që Konfirmon Marrjen Në Dorëzim Të Aktiveve Ekzistuese*). Shoqëria Koncesionare rezervon të drejtën e marrjes në dorëzim të një pasurie të paluajtshme që është në Okupim nëpërmjet një njoftimi me shkim të Autoriteti Kontraktues.

- (d) Nëse ndonjë pasuri e paluajtshme sipas Shtojcës 1 (*Inventari Ekzistues i Aktiveve*) nuk korrespondon me situatën faktike sipas planit të rilevimit, atëherë palët dakortësojnë përditësimin e Shtojcës 1 me marrëveshje.
- (dh) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Shoqëria Koncesionare, si përdorues dhe administrues i Zonës së Koncesionit, do të jetë përgjegjës dhe do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me ushtrimin e të drejtës së përdorimit dhe administrimit. Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës dhe nuk do të paguajë taksa ose kosto dhe shpenzime të tjera të lidhura me pronësinë nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Subjekt Shtetëror.
- (e) Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit ose kësaj Kontrate, e drejta e përdorimit dhe administrimit e pasurive të palujtshme do të përfundojë automatikisht dhe do të pushojë së patur efekt pas së cilit Autoriteti Kontraktues do të marrë në zotërim të gjitha asetet e dhëna në përdorim të Shoqëria Koncesionare (së bashku me Objektet e Reja të ndertuara në zonën e koncesionit).

Për të shmangur cdo lloj dyshimi, regjistrimi i pasurive të paluajtshme në zyrat vendore të pasurive të palujtshme sipas paragrafit (b) dhe përditësimi i inventarit ekzistues me marrëveshje sipas paragrafit (d) nuk çënon të drejtën e përdorimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme në Zonën e Koncesionit për të realizuar objektin e Kontratës nga Shoqëria Koncesionare në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate.

12. OBJEKTET E REJA NË ZONËN E KONCESIONIT

- (a) Shoqëria Koncesionare ka të drejta përdorimi dhe administrimi ndaj Objekteve të Reja që mund të krijohen gjatë Periudhës së Koncesionit në Zonën e Koncesionit.
- (b) Shoqëria Koncesionare do të ketë të drejtën e vetme për përdorimin e Objekteve të Reja, me përjashtim të Personave që përdorin Objektet e Reja si pasagjerë, kontraktues, përdorues të Hekurudhës dhe Persona të tjerë që përdorin Ambientet e Reja kanë detyrimin të mos ndikojnë negativisht tek të drejtat e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate.
- (c) Shoqëria Koncesionare është e aftë të krijojë Interes Sigurimi ndaj Objekteve të Reja, në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm. Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës dhe nuk paguan taksa ose kosto dhe shpenzime të tjera të lidhura me të drejtat pronësore nga Shoqëria Koncesionare të Objekteve të Reja.

13. OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA

13.1 Operimi dhe Mirëmbajtja

- (a) Shoqëria Koncesionare gjatë Periudhës së Koncesionit:
 - (i) administron Infrastrukturën Hekurudhore në cilësinë e Administruesit të Infrastrukturës në përputhje me këtë Kontratë;
 - (ii) operon Hekurudhën në cilësinë e Transportuesit Hekurudhor të Integruar në përputhje me këtë Kontratë; dhe
- (b) Gjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare do të mirëmbajë në gjendje funksionale dhe do të rinovojë/përmirësojë rrjetin hekurudhor, duke përfshirë godinat, pajisjet, sistemet dhe ambientet e tij të ndodhura në Zonën e Koncesionit, të gjitha në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm. Të gjitha punimet e mirëmbajtjes, riparimit dhe punime të tjera do të kryhen në mënyrë të tillë që të minimizojnë problemet për Përdoruesit e Hekurudhës sipas Ligjit të Zbatueshëm. Nëse ndonjë punim mirëmbajtjeje ose punime të tjera kërkojnë ndërprerjen ose pezullimin ose mbylljen (për cilëndo periudhë kohe) të Hekurudhës, Shoqëria Koncesionare do t'i japë Autoritetit Kontraktues dhe të gjithë Përdoruesve të cenuar të Hekurudhës një njoftim paraprak me shkrim, duke i informuar për këtë ndërprerje, pezullim ose mbyllje të kërkuar.
- (c) Gjatë Operimit, Shoqëria Koncesionare do të zbatojë kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 8 (*Studimi i Fizibilitetit*).

14. MARRJA NË DORËZIM E INVENTARIT TË AKTIVEVE TË HEKURUDHËS PAS VERIFIKIMIT FAKTIK

Pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës, Shoqëria Koncesionare kryen verifikimin e Aktiveve sipas Shtojcës 1 (*Inventari Ekzistues i Aktiveve*). Shoqëria Koncesionare merr në dorëzim Aktivitetet vetëm pas verifikimit që (i) Aktivitetet ekzistojnë; (ii) janë të lirë nga ndonjë Okupim, Interes Sigurimi, detyrim, qera, barrë dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga palë të treta; (iii) situata faktike përkon me kushtet dhe pershkrimin e Shtojcës 1 nëpërmjet procesverbalit sipas Shtojcës 5 (*Forma E Procesverbalit Nga Autoriteti Kontraktues Dhe Shoqëria Koncesionare Që Konfirmon Marrjen Në Dorëzim Të Aktiveve Ekzistuese*). Ky proces fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi të Kontratës dhe vazhdon deri në Datën e Fillimit të Periudhës së Koncesionit por në asnjë rast të mos kalojë periudhën prej 28 muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi.

15. TARIFAT E HEKURUDHËS DHE RISHIKIMI I PAVARUR EKONIMIK

Në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm që rregullon aktivitetin hekurudhor, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të vendosi vetë tarifatat për çdo lloj shërbimi për Hekurudhën, përveç se ato të parashikuar në Nenin 15.1 më poshtë.

15.1 Metodologjia e Përlogarritjes së Tarifave të Përdoruesve të Tretë të Hekurudhës

Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të vendosë Tarifat e Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës gjatë Periudhës së Koncesionit sipas metodologjisë të përcaktuar në Shtojcën 3 (*Metodologjia e Përlogarritjes së Tarifave të Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës*). Miratimi i Tarifave për Transportuesit e Tjerë të Hekurudhës bëhet sipas Ligjit të Zbatueshëm.

15.2 Propozimi për Rishikimin Periodik i Tarifave të Hekurudhës

Shoqëria Koncesionare ka të drejtën të propozojë rishikimin e Tarifave të Transportuesve të Tjerë të Hekurudhës çdo 4 (katër) vjet gjatë Periudhës së Koncesionit. Shoqëria Koncesionare përgatit një propozim për ndryshime në çdo rishikim periodik. Çdo propozim shoqërohet me dokumentacion me shkrim të supozimeve të përdorura dhe llogaritjeve të bëra gjatë përgatitjes së tij dhe miratohet nga Autoriteti Kontraktor.

15.3 Deklarata e Rrjetit

- (a) Shoqëria Koncesionare publikon Deklaratën e Rrjetit sipas Ligjit të Zbatueshëm që rregullon aktivitetin hekurudhor. Qëllimi i Hartimit të Deklaratës së rrjetit është që të gjithë operatorët hekurudhorë të njihen me gjëndjen e Infrastrukturaes Hekurudhore dhe kushtet e shfrytëzimit të saj.
- (b) Deklarata e rrjetit duhet të përmbaje përshkrimin e Infrastrukturaes Hekurudhore, rregullat e përgjithëshme për aplikim për përdorim të linjes hekurudhore, skemen dhe strukturën e pagesës të përdorimit të Infrastrukturaes Hekurudhore, rregullat për alokimin e kapaciteteve dhe çdo informacion tjetër për raportet e punës ndërmjet Administruesit të Infrastrukturaes dhe Operatoreve Hekurudhore.

16. SIGURIMI I ASETEVE

- (a) Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, me qëllim garantimin e një aktiviteti të pandërprerë, Shoqëria e Koncesionit duhet të bëjë sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, aseteve ekzistuese dhe të krijuara sipas vlerës kontabile të pasqyruar në bilanc, nga çdo ngjarje, rrethanë apo Forcë Madhore, brenda kufijve të përgjegjësisë që mbulohen me sigurim, jo më pak se 70% të vlerës së investuar.
- (b) Për këtë qëllim, Shoqëria Koncesionare do të paraqesë çdo vit pranë autoritetit kontraktues dokumentin përkatës që vërteton sigurimin, lëshuar nga institucioni përkatës. Sigurimi do të kryhet në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.
- (c) Të gjitha shumat financiare të marra sipas policave të sigurimit do të aplikohen menjëherë nga Shoqëria Koncesionare për riparimin ose rinovimin, ose zëvendësimin e ambienteve të lidhura me Projektin ose ndonjë pjesë të tij që mund të jetë dëmtuar ose shkatërruar. Shoqëria Koncesionare do të kryejë këtë riparim ose rinovim ose restaurim ose zëvendësim në masën e mundshme, në mënyrë të tillë që ambientet në lidhje me Projektin ose ndonjë pjesë e tyre, pas këtij riparimi ose zëvendësimi, do

të jetë për aq sa është e mundur në të njëjtën gjendje që ato ishin para këtij dëmi ose shkatërrimi.

17. PËRGJEGJËSITË DHE KUFIZIMI I PËRGJEGJËSIVE

17.1 Përgjegjësitë

- (a) Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjës për çdo humbje thelbësore dhe dëm të pësuar te Autoriteti Kontraktues dhe/ose ndonjë Subjekti Shtetëror që lind nga ndonjë shkelje e kësaj Kontrate nga Shoqëria Koncesionare. Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës kur kjo shkelje është shkaktuar drejtpërdrejt nga një Ndryshim në Ligjin e Zbatueshëm.
- (b) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për çdo humbje thelbësore dhe dëm të pësuar te Shoqëria Koncesionare që lind nga ndonjë shkelje e detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues.

17.2 Lehtësimi i Humbjes

Në të gjitha rastet pala që konstaton ose pretendon shkelje të kontratës ose të drejtës për t'u zhdëmtuar në përputhje me këtë Kontratë, do të ketë detyrimin për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për lehtësimin e humbjes që ka ndodhur, *me kusht që të mund ta bëjë këtë pa vështirësi ose kosto të paarsyeshme*. Çdo pamundësi lehtësimi nga pala që konstaton ose pretendon këtë shkelje kontrate ose të drejtë për zhdëmtim, do të çojë në reduktim të dëmshpërblimit. Ky reduktim do të përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit e caktuar në përputhje me Nenin 31 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).

18. FORCA MADHORE

18.1 Raste të Forcës Madhore

- (a) Rasti i Forcës Madhore nënkupton rastet dhe rrethanat e mëposhtme:
 - (i) çdo akt lufte (qoftë i shpallur apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur ose akt të një armiku të huaj, rebelim ose terrorizëm, në çdo rast që përfshin ose prek drejtpërdrejt Republikën e Shqipërisë;
 - (ii) revolucioni, trazirat, rebelimi ose trazira të tjera civile, akte terrorizmi ose sabotazhi, në çdo rast që përfshijnë ose prekin drejtpërdrejt Republikën e Shqipërisë;
 - (iii) greva që janë të përhapura dhe/ose në të gjithë vendin dhe/ose greva politike;
 - (iv) tërmet, përmytje, zjarr, uragan ose ndonjë forcë tjetër madhore ose fatkeqësi natyrore mjedisore që prek drejtpërdrejt ose tërthorazi Zonën e Koncesionit. Vetëm në rastin e një përmytjeje në Zonën e Koncesionit,
 - (v) ndotje bërthamore, kimike ose biologjike që prek drejtpërdrejt ose tërthorazi Zonën e Koncesionit, nëse burimi ose shkaku i kësaj

ndotjeje nuk është rezultat i veprimeve të Shoqërisë Koncesionare ose ndonjë prej Kontraktuesve të Shoqërisë Koncesionare;

- (vi) epidemitë ose murtaja që prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi Zonën e Koncesionit.
- (b) **"Rast i Forcës Madhore"** përfshin çdo rast ose rrethanë ose kombinim rastesh ose rrethanash që pengojnë plotësisht ose pjesërisht ndonjë palë nga përmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate por vetëm nëse dhe në masën që ky rast dhe rrethanë:
 - (i) në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohet apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga pala e cënuar;
 - (ii) pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmange pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
 - (iii) ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
 - (iv) pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar)

18.2 Arsyetimi i përmbushjes së detyrimeve

Asnjë palë nuk konsiderohet të jetë në Mospërmbushje të Detyrimeve sipas kësaj Kontrate kur dhe në masën që përmbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pengohet qoftë plotësisht ose pjesërisht, nga rrethana të Forcës Madhore që lindin pas datës së kësaj Kontrate dhe secila palë ka të drejtë të ndërpresë përmbushjen e detyrimeve të saj në masën që ajo palë pengohet plotësisht ose pjesërisht nga kryerja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nga kjo rrethanë e Forcës Madhore.

18.3 Detyrimi për njoftimin e një Force Madhore

Nëse secila prej palëve mbështetet në ndodhjen e një Force Madhore si arsye për t'u shfajësuar nga përmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, pala që mbështetet tek rasti ose gjendja do t'i japë njoftim të menjëhershëm palës tjetër mbi ndodhjen e rastit ose gjendjes që jep një vlerësim të kohëzgjatjes së saj të pritshme dhe ndikimit të mundshëm ndaj përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

18.4 Detyrimi për ndreqjen e një Force Madhore

Në bazë të Nenit 18.3 (*Detyrimi për njoftimin e një Force Madhore*) më lart, nëse një nga palët do të mbështetet në ndodhjen e një Rasti të një Force Madhore si arsye për t'u shfajësuar nga mospërmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, pala që mbështetet tek rasti ose gjendja:

- (a) do të ushtrojë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të vazhduar të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate;
- (b) do të marrë masa brenda një kohe të shpejtë për të ndrequr ose korrigjuar rastin ose gjendjen që shfaqëson përmbushjen e detyrimeve;
- (c) do të ushtrojë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të lehtësuar ose kufizuar dëmin ndaj palës tjetër, në masën që ky veprim nuk do të ndikojë negativisht tek interesat e saj; dhe
- (ç) do t'i japë njoftime periodike palës tjetër në lidhje me veprimet dhe planet e saj për veprime në përputhje me pikat (a), (b) dhe (c) më lart dhe njoftim të menjëhershëm palës tjetër mbi ndërprerjen e rastit ose gjendjes që e shkakton atë, duke u shfaqësuar nga përmbushja e detyrimeve nëse një mosmarrëveshje lind ndërmjet Palëve nëse rasti ose gjendja që shkakton një Rast të një Force Madhore, është duke vazhduar. Në këtë rast Palët do ta referojnë çështjen për zgjidhje në përputhje me Nenit 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).

18.5 Shtyrja e Periudhës së Koncesionit për shkak të një Force Madhore

Në bazë të Nenit 21.2 (*Zgjidhja për shkak të një Force Madhore të Zgjatur*), nëse ndodh një Rast i një Force Madhore me kohëzgjatje më të gjatë se 2 muaj, atëherë Periudha e Koncesionit do të shtyhet për periudhën e asaj Force Madhore.

19. NDËRHJRJA

19.1 E Drejta e Ndërhyrjes

Autoriteti Kontraktues dhe ndonjë Subjekt Shtetëror kanë të drejten të ndërhyjnë ose ndërpresin rehabilitimin, përfundimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e Hekurudhës, sipas parashikimeve të mëposhtme:

- (a) Autoriteti Kontraktues, vetë ose nëpërmjet Subjektit Shtetëror, mund të ndërhyjë ose ndërpresë rehabilitimin, përfundimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e Hekurudhës **vetëm** për arsye të mbrojtjes kombëtare.
- (b) Asnjë ndërprerje ose ndërhyrje e tillë nuk do të ketë një kohëzgjatje ose shtrirje më të madhe sesa është e nevojshme, duke marrë parasysh rrethanat që shkaktojnë ndërhyrjen.

20. RASTE MOSPËRMBUSHJE TË DETYRIMEVE TË KONTRATËS

20.1 Mospërmbushjet e Shoqërisë Koncesionare

Secila nga ngjarjet e mëposhtme përbën një rast mospërmbushje nga ana e Shoqërisë Koncesionare ("*Mospërmbushjet e Shoqërisë Koncesionare*").

- (a) Shoqëria Koncesionare nuk përmbush detyrimet sipas kësaj Kontrate dhe ka dështuar të mbyllë këtë shkelle brenda periudhës përkatëse të përcaktuar në këtë kontratë, kjo periudhë nuk do të jetë më pak se 180 ditë.

- (b) Shoqëria Koncesionare falimenton.

20.2 Pasojat e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare

- (a) Pa paragjykuar të drejta të tjera ose kompensimin që Autoriteti Kontraktues gëzon sipas kësaj Kontrate, pas ndodhjes së rastit të mospërmbushjes nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të dërgojë një kërkesë me shkrim te Shoqëria Koncesionare ku kërkon që ky i fundit të rregullojë mospërmbushjen përkatëse brenda periudhës të përcaktuar në kërkesën me shkrim jo me shume se 30 ditë.
- (b) Shoqëria Koncesionare duhet menjëherë (duke marrë parasysh natyrën e mospërmbushjes) t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një plan të shkruar për rregullimin e këtyre mospërmbushjeve dhe të zbatojë pa vonesë këtë plan, siç është rënë dakord me Autoritetin Kontraktues.
- (c) Në rast se Shoqëria Koncesionare, për çfarëdo arsye, nuk do të rregullojë mospërmbushjen përkatëse brenda periudhës së caktuar nga Autoriteti Kontraktues, kjo mospërmbushje do të bëhet shkelje thelbësore e Kontratës menjëherë pas skadimit të periudhës kohore për rregullimin e saj dhene nga Autoriteti Kontraktues, dhe përbën kusht për Zgjidhje të Kontratës në mënyrë të njëanshme sipas përcaktimeve të Nenit 21 më poshtë.

20.3 Mospërmbushjet e Detyrimeve të Autoritetit Kontraktues

Ngjarjet e mëposhtme përbëjnë rastet e mospërmbushjeve nga ana e Autoritetit Kontraktues ("*Mospërmbushjet e Autoritetit Kontraktues*").

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe nuk ka rregulluar këtë mospërmbushje brenda periudhës përkatëse të përcaktuar në këtë kontratë, kjo periudhë nuk do të jetë më pak se 30 ditë.
- (b) Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Subjekt Shtetëror, nga veprimet e tij ose për shkak të mos veprimit nuk përmbush detyrimet e marra përsipër në këtë Kontratë.
- (c) Çdo përfaqësim i bërë ose garanci e dhëna nga Autoriteti Kontraktues sipas kësaj Kontrate rezulton të jetë jo i saktë dhe i pamundur.

20.4 Pasojat e Mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktues

- (a) Pa paragjykuar të drejta të tjera ose kompensimin që Shoqëria Koncesionare gëzon sipas kësaj Kontrate, pas ndodhjes së rastit të mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktues, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të dërgojë një kërkesë me shkrim për Autoritetin Kontraktues ku kërkon që ky i fundit të rregullojë mospërmbushjen përkatëse brenda periudhës së arsyeshme të përcaktuar në kërkesën me shkrim.
- (b) Autoriteti Kontraktues duhet menjëherë (duke marrë parasysh natyrën e mospërmbushjes) t'i ofrojë Shoqërisë Koncesionare një plan të shkruar për

rregullimin e këtyre mospërbushjeve dhe të zbatojë pa vonesë këtë plan, siç është rënë dakord me të.

- (c) Në rast se Autoriteti Kontraktues, për çfarëdo arsye, nuk do të rregullojë mospërbushjen përkatëse brenda periudhës së caktuar, kjo mospërbushje do të bëhet shkelje thelbësore menjëherë pas skadimit të periudhës kohore, për rregullimin e saj dhënë nga Shoqëria Koncesionare, dhe përbën kusht për Zgjidhje të Kontratës në mënyrë të njëanshme sipas përcaktimeve të Nenit 21 mëposhtë.

20.5 Të Drejta të Vecantë për Kompensimin (right to set-off)

Pa paragjykuar të drejta të tjera që Shoqëria Koncesionare mund të ketë sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare do të ketë të drejtën për të vendosur çdo shumë të maturuar dhe të pagueshme nga Shoqëria Koncesionare për Autoritetin Kontraktues ose ndonjë subjekt shtetëror (duke përfshirë, pa kufizim, taksat) kundrejt shumës të pagueshme nga Shoqëria Koncesionare te Autoriteti Kontraktues ose ndonjë enti shtetëror sipas kësaj Kontrate.

21. ZGJIDHJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT

21.1 Zgjidhja pas Ndërhyrjes

Shoqëria Koncesionare ka të drejtë që 60 ditë pas datës së parë të Ndërhyrjes nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Subjekt Shtetëror, *me kusht që* kjo ndërhyrje të jetë duke vazhduar, të zgjidhë këtë Kontratë duke i dhënë Autoritetit Kontraktues një Njoftim mbi Zgjidhjen.

21.2 Zgjidhja për shkak të një Force Madhore të Zgjatur

- (a) Nëse një Rast i një Force Madhore vazhdon ose sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve, mund të vazhdojë për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, përveç të drejtës të përcaktuar në Nenin 18.5 (*Shtyrja e Periudhës së Koncesionit për shkak të një Force Madhore*), secila palë mund t'i japë fund kësaj Kontrate duke i dhënë Njoftim Palës tjetër në lidhje me Përfundimin.
- (b) Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë një vlerësim të pavarur nga një ekspert i kualifikuar në lidhje me vlerën e aseteve të tij (mbi bazën e një kostoje historike të zhvlerësuar), duke marrë në konsideratë gjendjen e këtyre aseteve dhe koston e korrigjimit për t'i sjellë asetet në gjendjen e kërkuar, për qëllim të përputhshmërisë me këtë Kontratë. Çdo shtesë e vlerës së vendosur nga ky ekspert i kualifikuar në lidhje me shumën e kompensimit të llogaritur do të paguhet nga Shoqëria e Sigurimit për llogari të Shoqërisë Koncesionare. Raporti i vlerësimi i përgatitur nga eksperti do të jetë detyrues për Palët. Shtesa e vlerës së përcaktuar nga raporti i vlerësimit do të paguhet si një shumë e vetme e plotë.

21.3 Zgjidhja nga Autoriteti Kontraktues për shkak të Mospërbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare

- (a) Pa cënuar ndonjë të drejtë tjetër që mund të ketë sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë këtë Kontratë pas dhënies së një

Njoftimi Palës tjetër mbi Zgjidhjen, nëse ndodh ndonjë prej rasteve të mëposhtme ("**Rasti i Zgjidhjes nga Autoriteti Kontraktues**"):

- (i) pamundësia e Shoqërise Koncesionare që pas një periudhe 60 mujore nga Data e Fillimit të Përiudhës së Koncesionit, të përfundojë Punimet e Rehabilitimit;
 - (ii) një Rast Falimenti ndodh me Shoqërinë Koncesionare;
- (b) Në Rastin e Zgjidhjes së Kontratës nga Autoriteti Kontraktues për shkak të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën t'i japë njoftim Shoqërisë Koncesionare, duke specifikuar se ka ndodhur një ose disa shkelje të kësaj Kontrate, natyrën e rrethanave përkatëse dhe (nëse është i aftë të korrigjojë shkeljen) kërkon nga Shoqëria Koncesionare të ndreqë këtë situatë brenda periudhës së korrigjimit të përcaktuar në njoftim, por jo më shumë se 30 ditë të njëpasnjëshme pune nga data e marrjes dijeni. Kjo periudhë korrigjimi duhet të jetë e arsyeshme për një rast specifik. Nëse Shoqëria Koncesionare kundërshton se ka ndodhur Rasti i Përfundimit të përmendur në njoftimin e dhënë nga Autoriteti Kontraktues, Shoqëria Koncesionare do të ketë të drejtë brenda 30 ditëve pas datës së marrjes të njoftimit, t'ia drejtojë këtë mosmarrëveshje arbitrazhit, në përputhje me Nenin 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).
- (c) Nëse rrethana përkatëse që shkakton Rastin e Zgjidhjes, nuk mund të rregullohet përpara përfundimit të periudhës së korrigjimit të përcaktuar në njoftim, Autoriteti Kontraktues do të zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me Nenin 28.1 (*Të Drejtat e Ndërhyrjes së Huadhënësit*). Nëse Autoriteti Kontraktues zgjedh të mos i japë fund kësaj Kontrate në përputhje me Nenin 28.1(a), Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Huadhënësin për këtë, duke përcaktuar se Huadhënësi ka 60 ditë (ose ndonjë periudhë më të gjatë që mund të përcaktohet në njoftim) brenda të cilës të zbatojë Kontratë. Nëse Huadhënësi e zbaton Kontratën duke respektuar të drejtat e Ndërhyrjes nga Huadhënësi, Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë pasi Huadhënësi të ketë patur një periudhë të arsyeshme brenda të cilës të korrigjojë Rastin e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare.
- (ç) Nëse Huadhënësi nuk zbaton Kontratën që rregullon të drejtat e ndërhyrjes së Huadhënësit, Autoriteti Kontraktues do të zgjidhë këtë Kontratë nëpërmjet një njoftimi përfundimtar.

21.4 Zgjidhja nga Shoqëria Koncesionare për shkak të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues

- (a) Pa cënuar ndonjë të drejtë tjetër që mund të ketë sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare mund të zgjidhë këtë Kontratë pas dhënies së një Njoftimi mbi Zgjidhjen për Palën tjetër, nëse ndodh ndonjë prej rasteve të mëposhtme ("**Rasti i Zgjidhjes nga Shoqëria Koncesionare**"):
- (i) shkelje e ndonjë prej detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues që ka ndodhur dhe është duke vazhduar për 30 Ditë të njëpasnjëshme Pune pas datës së një njoftimi të vlefshëm për korrigjim, të lëshuar nga Shoqëria Koncesionare;

- (ii) pas zbulimit arkeologjik të Zonës së Koncesionit, të ndërmarrë në përputhje me Nenin 6.3(ç) (*Rehabilitimi*), konfirmimi se ndodhen struktura ose objekte të një interesi të veçantë gjeologjik ose arkeologjik, ekzistenca e të cilave për një periudhë më të gjatë se 180 ditë të njëpasnjëshme e cila pengon Shoqërinë Koncesionare të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate;
 - (iii) shkelje nga Autoriteti Kontraktues (duke përfshirë çdo Subjekt Shtetëror) të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate që në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet Palëve vazhdon të mos jetë i korrigjuar për më shumë se 60 ditë të njëpasnjëshme pas datës së marrjes nga Palët të një vendimi të një gjykate arbitrazhi të caktuar në përputhje me Nenin 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*); ose
 - (iv) shkelje të ndonjë prej të gjitha përfaqësimeve dhe garancive të Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në Nenin 24.1 (*Autoriteti Kontraktues*).
- (b) Në Rastin e Zgjidhjes nga Shoqëria Koncesionare për shkak të të Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë t'i japë njoftim Autoritetit Kontraktues, duke specifikuar se ka ndodhur një shkelje e kësaj Kontrate, natyrën e rrethanave përkatëse dhe (nëse është i aftë për ta korrigjuar shkeljen), i kërkon Autoritetit Kontraktues ta korrigjojë këtë shkelje brenda periudhës së korrigjimit të përcaktuar në njoftim, por jo me shumë se 30 ditë të njëpasnjëshme pune nga data e marrjes dijeni. Kjo periudhë korrigjimi duhet të jetë e arsyeshme për një rast specifik. Nëse Autoriteti Kontraktues kundërshton se ka ndodhur Rasti i Zgjidhjes, i përmendur në njoftimin e dhënë nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë, brenda 30 ditëve pas datës së marrjes së njoftimit, për t'ia drejtuar këtë mosmarrëveshje arbitrazhit, në përputhje me Nenin 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).
- (c) Shoqëria Koncesionare ka të drejtën e zgjidhjes së kësaj kontrate, nëse ka mundësi kompensimi nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të paguajë shumën e kompensimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare brenda 30 ditëve nga marrja e një kërkesë të tillë. Nëse Autoriteti Kontraktues do të kontestojë vlefshmërinë e kërkesës ose shumën e kompensimit të kërkuar, dhe nëse Autoriteti Kontraktues dhe Shoqëria Koncesionare nuk janë në gjendje të zgjidhin këto mosmarrëveshje brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, atëherë Palët mund të referojnë mosmarrëveshjen për arbitrazh, në përputhje me Nenin 29 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).

21.5 Mbijetesa pas Zgjidhjes

Mbarimi i afatit të zgjidhjes të kësaj Kontrate (sido që të ndodhë ajo), nuk duhet të cenohet të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjërit prej palëve, as dhe hyrjen në fuqi apo vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Kontratë, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të hyjë në fuqi apo të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të përfundimit, ose të përfundimit të pjesshëm, që përfshin pa kufizim dispozitat e Nenit 17 (*Detyrimet dhe Kufizimi i Përgjegjësive*), Nenit 26 (*Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale*), Nenit 27 (*Konfidencialiteti*), Nenit 29

(Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) dhe Nenit 31 (Legjislacioni në Fuqi) do të mbijetojnë pas përfundimit të kësaj Kontrate.

22. PËRFAQËSIME DHE GARANCI

22.1 Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues parfaqëson, garanton dhe merr përsipër para Shoqërisë Koncesionare se:

- (a) ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë kontratë;
- (b) si rezultat i dhënies të së drejtës për përdorim lidhur me Zonën e Koncesionit dhe dorëzimit të Zonës së Koncesionit të Shoqëria Koncesionare, ky i fundit duhet t'i garantohet e drejtë e vetme për të përdorur dhe zotëruar Zonën e Koncesionit;
- (c) Zona e Koncesionit në pronësi të Shtetit Shqiptar dhe në administrim të Autoriteti Kontraktues është dhe do të mbetet e lirë nga Okupimi, pretendimet, barrët etj. gjatë periudhës së koncesionit pavarësisht pretendimeve të palëve të treta. Në çdo rast të pretendimeve nga të tretët apo konflikteve të mundshme, Autoriteti Kontraktues deklaron se do të jetë pala që merr përsipër përfaqësimin dhe zgjidhjen e pretendimeve/konfliktit me të tretët;
- (ç) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e hyrjes së tij në këtë Kontratë dhe përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate;
- (d) kjo kontratë do të jetë e vlefshme, efektive, detyruese dhe e zbatueshme në përputhje me kushtet e saj sipas Ligjit të Zbatueshëm;
- (dh) në momentin e nënshkrimit nuk ekziston asnjë ligj, vendim i këshillit të ministrave (VKM), udhëzim, urdhër ose ndonjë pengesë tjetër ligjore që kufizon, ndalon ose shpall të paligjshme këtë koncesion;
- (d) në momentin e nënshkrimit nuk ekziston asnjë kërkesë padi, proces hetimor nga palë të treta ose Subjekte të tjeta Shtetërore që kërkon të kufizojë, ndalojë ose shpallë të paligjshme këtë koncesion;

Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e Autoritetit Kontraktues sipas këtij Neni duhet të përsëriten nga ky i fundit çdo ditë gjatë periudhës së koncesionit duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese.

22.2 Shoqëria Koncesionare

Shoqëria Koncesionare parfaqëson, garanton dhe merr përsipër para Autoritetit Kontraktues se:

- (a) është një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ka si objekt të vetëm kryerjen e veprimtarive, të cilat, sipas kësaj Kontrate, janë të lidhura me Koncesionin;
- (b) nuk është subjekt i ndonjë falimentimi;

- (c) është në përputhje të plotë me ligjin e Zbatueshëm dhe dispozitat në fuqi të kësaj Kontrate;
- (ç) ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontratë dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të marrë këtë autorizim nënshkrimi të kesaj Kontrate, si dhe përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;
- (d) ka gjendje financiare dhe kapacitet për të realizuar Projektin;

23. TRANSFERIMI

- (a) Në përfundim të Periudhës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues:
 - (i) Infrastrukturën Hekurudhore;
 - (i) të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë (me kusht që këto përgjegjësi të mos mbartin kosto financiare) e Shoqërisë Koncesionare në lidhje me koncesionin;
- (b) Në përfundim të Periudhës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjidhshmërisht të lidhura me veprimet e dorëzimit të Aktiveve të Autoritetit Kontraktues.
- (c) Procesi i dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të periudhës koncesionare pas një inspektimi të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Shoqërisë Koncesionare.

24. INSPEKTIMET

Pas Datës së Fillimit të Periudhës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues ose çdo subjekt tjetër shtetëror, mund të inspektojë Zonën e Koncesionit, për punimet e rehabilitimit, menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore.

25. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

25.1 Transferimi nga Shoqëria Koncesionare

Çdo transferim i aksioneve/kapitalit themeltar të Shoqërisë Koncesionare tek të tretet, do të kryhet me miratimin e Autoritetit Kontraktues brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës. Me transferimin e aksioneve/kuotave të kapitalit themeltar, palës së tretë do t'i transferohen detyrimet dhe të drejtat e përcaktuara në Kontratën e Koncesionit.

25.2 Transferimi nga Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues do të transferojë këtë Kontratë ose të drejtat dhe detyrimet që lindin sipas saj, me pëlqimin paraprak me shkrim të Shoqërisë Koncesionare.

26. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

- (a) Nëse të Drejtat e Pronës Inteljektuale zhvillohen posaçërisht nga Shoqëria Koncesionare dhe/ose punonjësit e tij për qëllimet e Projektit dhe në rrjedhën e ushtrimit të të drejtave dhe të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, këto të drejta do t'i takojnë Shoqërisë Koncesionare gjatë Periudhës së Koncesionit. Në fund të Periudhës së Koncesionit, të drejtat e pronësisë intelektuale do të transferohen tek Autoriteti Kontraktues.
- (b) Shoqëria Koncesionare siguron dhe ruan të pa dëmtur Autoritetin Kontraktues dhe ndonjë nga subjektet shtetërore nga çdo humbje, kosto, shpenzim, detyrim apo dëm të shkaktuar apo të krijuar, dhe të gjitha pretendimet, veprat, kërkesat dhe procedimet e bëra kundër tij, ndonjë prej tyre për apo në llogari të shkeljeve të të Drejtave të Pronësisë Inteljektuale në lidhje me të gjitha dokumentat, thelbësoret, pajisjet, makineritë, ose ndryshe të përdorura në lidhje me projektin.

27. KONFIDENCIALITETI

27.1 Qëllimi i Konfidencialitetit

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjese të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj Kontrate.

27.2 Informacionet e lejuara për zbulim

Neni 29.1 nuk do të zbatohet në shkallën që:

- (a) Ky informacion ka qenë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;
- (b) Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;
- (c) Ky informacion ka qenë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Kontrate; ose
- (d) Një informacion i tillë është i detyrueshëm për t'u nxjerrë sipas ligjit. Shoqëria Koncesionare, secili aksioner/ortak dhe shoqëritë e tyre përkatëse mëmë kanë të drejtë të zbulojnë informacione.

28. E DREJTA E NDËRHJRJES SË HUADHËNËSIT

28.1 E Drejta e Ndërhjrjes se Huadhënësit

- (a) Në rast se Shoqëria Koncesionare është në mospërmbushje të detyrimeve të saj dhe Autoritetit Kontraktues ka njoftuar Shoqërinë Koncesionare për zgjidhjes e Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues gjithashtu njoft-

ton Huadhënësin të fillojë ushtrimin e të drejtave të veta sipas kontratës që rregullon të drejtat e Huadhënësit brenda 90 ditëve.

- (b) Huadhënësi merr të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit të Zbatueshëm në mënyrë që të ushtrojë të drejtat e veta mbi Shoqërine Koncesionare dhe njofton Autoritetin Kontraktues.
- (c) Huadhënësi ka të drejtë:
 - (i) të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, në veçanti, për:
 - (1) të administruar dhe kryer çdo veprimtari të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Koncesionin;
 - (2) të caktoje një ose disa administratorë eksperte për të menaxhuar veprimatrinë /aktivet e Shoqërisë Koncesionare;
 - (3) të ushtrojë të gjitha të drejtat e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate për aq kohë sa të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate nuk janë përmbushur;
 - (3) të menaxhojë të gjitha të drejtat dhe aktivet e Shoqërisë Koncesionare dhe të ushtrojë të gjitha të drejtat, ashtu siç Huadhënësi do të vepronte nëse do të ishte pronari përfitues i këtyre të drejtave dhe aktiveve, duke përfshirë, pa kufizim çdo veprimtari ekonomike, juridike, tregtare, operationale, drejtuese dhe menaxheriale, të rregullojë ose të ofrojë të gjitha shërbimet të cilat Huadhënësi mund të gjykojë të përshtatshme për ushtrimin dhe menaxhimin efikas të drejtave koncesionare dhe aktiveve;
 - (4) të kryejë të gjitha veprimet e tjera që Huadhënësi konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për ushtrimin e të drejtave të dhëna në bazë të kontratës që rregullon të drejtat e Huadhënësit.

29. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

29.1 Zgjidhja

- (a) Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në, çështjet që lidhen me zgjidhjen, shkeljen, pavlefshmërinë, ose efektet para dhe post-kontraktuale, në bazë të kësaj Kontrate (“Mosmarrëveshje”) do të referohen nga Palët e përfshira në mosmarrëveshje fillimisht me përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktues dhe përfaqësuesin e Shoqërisë Koncesionare, të cilët do të takohen dhe do të përpiqen të zgjidhin çështjet mes tyre. Vendim i përbashkët dhe unanim i përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues dhe i përfaqësuesit të Shoqërisë Koncesionare do të jetë një marrëveshje përfundimtare dhe detyruese për Palët në mosmarrëveshje. Palët do të angazhohen të fillojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes menjëherë nga njoftimi i palës së interesuar. Në cdo rast, Palët duhet të arrijnë marrëveshjen brenda një afati 30 ditor në bazë të negociimeve intensive, në fund të të cilit duhet të dalin me marrëveshjen përkatëse.

- (b) Pala që dëshiron të fillojë këtë procedurë do t'i dërgojë një njoftim me shkrim palës tjetër. Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues dhe ai i Shoqërisë Koncesionare nuk takohen, apo nëse Mosmarrëveshja nuk është zgjidhur, brenda 1 (një) muaji pas marrjes së njoftimit, çdo palë në mosmarrëveshje mund të kërkojë ta referojë mosmarrëveshjen për arbitrazh në përputhje me Nenin 29.2 (*Arbitrazhi*).

29.2 Arbitrazhi

- (a) Sipas Nenit 29.1 (*Zgjidhja*), çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombetare të Tregtisë (ICC Rules) në fuqi në kohën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- (b) Numri i arbitrave të arbitrazhit do të jetë tre. Emërimi i arbitrave do të bëhet në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit ICC në fuqi në kohën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri. Gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Shpenzimet e tij do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit.

29.3 Masat paraprake

Asgjë në këtë Kontratë nuk pengon Palën t'i kërkojë arbitrazhit të marrë urdhra paraprake ose masa të përkohshme për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Kontratë.

29.4 Detyrimi i Vazhdueshëm

As fillimi dhe as organizmi i negociatave në çfarëdo forme apo mënyre të parashikuar në këtë Kontratë nuk do të shkarkojnë, paragjykojnë ose ndikojnë në detyrimet e ndonjëres prej Palëve sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë edhe performancën nga ana e Palës.

30. TË NDRYSHME

30.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Kontratë dhe dokumentat e referuara përmbajnë marrëveshjen e plotë mes Palëve në lidhje me transaksionet e parashikuara në këtë Kontratë dhe secila prej Palëve pranon se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk është mbështetur në përfaqësime ose garanci, me përjashtim të atyre të përcaktuara në këtë Kontratë.

30.2 Njoftimet

- (a) Çdo njoftim sipas kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim dhe mund t'i dorëzohet, adresohet ose dërgohet palëve si më poshtë (ose në një adresë tjetër ose numër faksi, që Pala mund të zëvendësojë duke njoftuar pas datës së kësaj Kontrate:

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Njësia e Zbatimit të Projektit
Sheshi Skënderbej
Tiranë, Shqipëri

Shoqëria Koncesionare ALBRAIL sh.p.k.
Godina 18/2, Rruga Nikolla Jorga, Njesia Bashkiake nr.7,
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2258372
E-mail: info@albrail.al

- (b) Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera sipas kësaj kontratë për ndonjë palë të kësaj Kontrate do të konsiderohen si të dhëna ose kryera kur dorëzohen (në rastin e dorëzimit në dorë apo me postë) ose kur merret me e-mail ose faks. Çdo njoftim ose komunikim tjetër sipas kësaj Kontrate dhënë nga Shoqëria Koncesionare për Autoritetin Kontraktues do të deklarohet qartë se ai i referohet Koncesionit dhe kësaj kontrate.
- (c) Njoftimi ose komunikimi i marrë në një ditë jo-pune ose pas orarit zyrtar të punës në vendin e marrjes, do të përdoren në ditën e ardhshme të punës në këtë rast.

30.3 Heqja dorë

- (a) Asnjë dështim apo vonesë në ushtrimin nga ana e Shoqërisë Koncesionare ose Autoriteti Kontraktues, e çdo të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Kontrate nuk do të veprojnë si një heqje dorë.
- (b) Heqja dorë nga Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktues nga ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Kontrate nuk do të jetë efektive nëse nuk bëhet me shkrim.

30.4 Ndashmëria

Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në çfarëdo juridiksioni, kjo pavlefshmëri, paligjshmëri ose pazbatueshmëri nuk do të zhvleftësojë dispozitat e mbetura të kësaj Kontrate ose ndikojë në ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitës në ndonjë juridiksion tjetër.

30.5 Kopjet

Kjo Kontratë është ekzekutuar në 5 (pesë) kopje të njëjta të cilat të marra së bashku përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

30.6 Gjuha

Kjo Kontratë do të nënshkruhet në gjuhën shqipe. Një version të përkthyer në anglisht me vërtetim përkthimi do të bashkëngjitet. Në rast mospërputhjeje midis versionit në gjuhën angleze të kësaj Kontrate dhe tekstit në shqip të saj, do të mbizotërojë versioni në shqip i saj. Çdo dokument i përmendur në këtë Kontratë, apo që do të dorëzohet sipas kësaj Kontrate do të jetë në gjuhën shqipe, siç kërkohet.

30.7 Ndryshimet

Asnjë modifikim, amendim apo ndryshim tjetër në këtë Kontrate nuk do të jetë detyrues mbi çdo palë nëse nuk bihet dakord me shkrim nga të gjitha palët. Autoriteti Kontraktues ka autoritetin të miratojë dhe nënshkruajë modifikimin, amendimin ose ndryshimin në këtë Kontrate. Autoriteti Kontraktor shpreh aprovimin që, në bazë të kërkesës nga Shoqëria Koncesionare, të negociojnë në mirëbesim ndonjë modifikimin, amendim apo ndryshim tjetër në këtë Kontratë, i cili do të konsiderohet i nevojshëm ose i përshtatshëm nga ana e Shoqëria Koncesionare.

30.8 Dokumentat shtesë dhe Veprimet

Secila nga Palët pajtohet t'i dorëzojë tjetrës dokumentat shtesë, dhe të ndërmarrë veprime shtesë, nëse konsiderohet e nevojshme për zbatimin dhe dhënien e efektit të plotë ligjor kësaj Kontrate.

30.9 Heqja dorë nga Imuniteti Sovran

Autoriteti kontraktues pajtohet se ekzekutimi, ofrimi dhe performanca e tij e kësaj Kontrate përbëjnë akte private dhe komerciale;

30.10 Ndryshimet në Ligj


- (a) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Shoqëria Koncesionare do të marrë parasysht ndryshimet jo-diskriminuese në ligjet që do të hyjnë në fuqi dhe efekt pas datës së kësaj Kontrate.
- (b) Nëse, si rezultat i drejtpërdrejtë i ndryshimeve përkatëse në ligj, Shoqëria Koncesionare do të pësojë rritje në kosto, shtim të tatim fitimit, ose barra të tjera financiare, efekti financiar agregat cili do të kalojë shumën prej [EUR 10,000] në çdo vit financiar, ai do të njoftojë këtë efekt financiar agregat te Autoriteti Kontraktues shoqëruar me analiza financiare të hollësishme dhe shpjegime, në mënyrë që të vërë veten në të njëjtin pozicion financiar që do të kishte qenë nëse nuk do të kishte pasur asnjë ndryshim në ligj.
- (c) Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Shoqërisë Koncesionare, në baza vjetore, çdo shumë të kërkuar për të vendosur veten në të njëjtin pozicion financiar në lidhje me çdo vit gjatë kohëzgjatjes së mbetur të periudhës së koncesionit, sic do të kishte qenë pa pasur asnjë ndryshim të tillë në ligj. Çdo llogaritje e efektit financiar e përmendur më lart do të marrë parasysht efektin kumulativ të Shoqëria Koncesionare i të gjitha ndryshimeve në ligj prej datës së kësaj Kontrate.

31. LEGJISLACIONI NË FUQI


Kjo Kontratë do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Unë, noteri vërtetoj që pasi ju lexua me zë të lartë dhe të qartë, palët deklarojnë që kuptojnë përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe meqënëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj këtë Kontratë sipas ligjit.

SI DËSHMI janë vendosur nënshkrimet e Palëve më 04/02.2016, në Tiranë, Republika e Shqipërisë, përpara noterit Fatmir Laçej.



MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
REPUBLIKA E SHQIPËRISË



ALBRAIL SHPK